

SHTOJCA 3g

Datë: 15/10/2025

## FTESË PËR OFERTË

Subjekti	BEPRO shpk
Objekti i prokurimit:	Objekti i prokurimit: Shërbime të marketingut dhe komunikimit – Branding & Fushata Dixhitale për promovimin e NEXORA
Buxheti maksimal (lekë, me TVSH):	2,542,498
Data e nisjes së prokurimit:	15/10/2025
Data e mbylljes së prokurimit:	29/10/2025

BEPRO shpk, në kuadër të programit NomadTech – Fuqizimi i Gjeneratës së Ardhshme të Novatorëve, zbatuar nga Shoqata LIBURNETIK, shpall ftesën për ofertë për ofrimin e një shërbimi të integruar që përfshin:

- Zhvillimin e identitetit vizual për produktin NEXORA
- Dizajnin e ndërfaqes së përdoruesit (UI) për sistemin CRM
- Zbatimin e fushatave reklamuese në rrjete sociale (Meta & Google Ads)
- Hartimin e raporteve mbi performancën e fushatave

**Kushtet për pjesëmarrje:**

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre deri më 29/10/2025 ora 16:00 në adresën: [nexora@bepro.al](mailto:nexora@bepro.al)

Nuk pranohen oferta të dorëzuara dorazi.

**Specifikimet teknike:**

Për këtë projekt, BEPRO shpk do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas pershkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/ shërbimit/	Çmimi/njësi me TVSH
1	Krijimi i brandbook (logo, ngjyra, font, stil komunikimi)	
2	Krijimi i dizajnit vizual për ndërfaqen e përdoruesit të platformës NEXORA (UI mockups për dashboard, module, statistika, etj.)	
3	Strategji dhe ekzekutim i fushatave në Meta & Google Ads	
4	2 Raporte mbi impaktin dhe rezultatet, afatmesëm dhe përfundimtar.	

## **Specifikime te pergjithshme teknike:**

### **1. Përvojë profesionale**

Të kenë eksperiencë të dokumentuar në fushën e marketingut, branding-ut ose fushatave dixhitale.

### **2. Dorëzim i materialeve**

Të gjitha produktet të dorëzohen në formate të përdorshme (.pdf, .png, .mp4) dhe në formate redaktueshme (.ai, .psd, .pptx, .docx etj).

### **3. Origjinaliteti dhe të drejtat e autorit**

Materialet duhet të jenë origjinale dhe të mos cenojnë të drejtat e palëve të treta.

### **4. Respektimi i afateve**

Ofertuesi duhet të angazhohet për dorëzim sipas kalendarit të përcaktuar në kontratë.

### **5. Bashkëpunim me ekipin e projektit**

Të jenë të gatshëm për komunikim dhe koordinim të rregullt me ekipin e NEXORA.

### **6. Konfidencialitet**

Të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të projektit dhe të mos përdorin asnjë material pa leje të shkruar.

## **Kushte të përgjithshme:**

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Tiranë
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e subjektit [nexora@bepro.al](mailto:nexora@bepro.al) brenda datës 29/10/2025

Nuk pranohen ofertat dorazi.

- 4) Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare sipas kushteve të kontratës dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesin të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Ekstraktin e QKB
- 2) Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.
- 4) Profili i kompanisë
- 5) Portofol punësh të meparshme (opsionale)

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.